



BASHKIA SHKODËR

SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri

Nr. 3334 prot.

Nr. 1078 prot.

Shkodër, më 73.23

Tiranë, më 07.03.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë / / 2023 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Bashkia Shkodër, me adresë: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër **Z. Bardh Spahia**, këtë e tutje i cilësuar si "Bashkia"

Dhe

SOS Fshati Fëmijëve, Shqipëri, me adresë: Bul. Zogu I, L'Qemal Stafa", Shkodër, Shqipëri; person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.4759 dt.19.07.1995; me nr. NIPT J62021005D; përfaqësuar nga Znj.**Adela Maçi**, me funksion Drejtor Kombëtar, identifikuar me kate identiteti I185729103D, që këtë e tutje e quajtur "**Organizata SOS Fshati Fëmijëve, Shqipëri**"

Këtë e tutje, **Palët** bien dakord të veprojnë me burimet në dispozicion si dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë me qëllimin për të fuqizuar dhe koordinuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe angazhimin/ndihmën e ndërsjelltë mbi bazën e posedimit të të drejtave të barabarta, marrëveshjeve ndërshtetërore dhe ndërqeveritare për ofrimin e shërbimeve shoqërore direkte të target-grupeve në nevojë.

NENI 1

Objekti dhe Qëllimi

- a. Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit institucional mes **Bashkisë Shkodër** dhe "**SOS Fshati Fëmijëve, Shqipëri**", të cilët kanë në fokus fëmijët dhe familjet vulnerabël, realizimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe

ofrimin e shërbimeve shoqërore me fokus të veçantë në shërbimet komunitare për fuqizimin e familjes dhe punësimin e të rinjve.

- b. Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve synon të nxisë modele pozitive, inovatore të ofrimit të shërbimeve për grupet e marxhinalizuara duke synuar përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të fëmijëve, familjeve vulnerabël në Bashkinë e Shkodrës dhe rritjes së kapaciteteve të profesionistëve vendorë për t'iu përgjigjur në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

NENI 2

Fushat e bashkëpunimit

- a) Koordinimin e shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe të fëmijëve të tjerë vulnerabël.
- b) Zbatimi i modeleve dhe praktikave të reja, duke zbatuar projekte e programe të përbashkëta pilot (ngritja e familjeve kujdestare, shërbimi social lëvizës, ¹deinstitutionalizimi në rajonin e Shkodrës).
- c) Përfundimin e kapaciteteve të profesionistëve të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të mekanizmave institucionalë, puna e të cilëve lidhet me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- d) Përmirësim i politikave dhe praktikave në mënyrë që fëmijët, të rinjtë, familjet dhe komunitetet të marrin një mbështetje më të mirë për kujdesin ndaj fëmijëve të tyre.
- e) Promovimin dhe realizimin e mekanizmave efektivë për pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha proceset që ndikojnë në të drejtat dhe mirëqenien e tyre.
- f) Ngritjen e grupeve të punës të përbashkëta, me qëllim realizimin e ndërhyrjeve në situata të caktuara apo në raste të caktuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- g) Shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë mes palëve në veçanti, për përditësimin e legjislacionit që rregullon mbrojtjen e fëmijës, kapacitetet dhe shërbimet e ofruara, si dhe çdo informacion tjetër që nuk është i natyrës konfidenciale nuk do të shpërndahet tek palët e treta.
- h) Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zbatuar bashkarisht aktivitetet sipas kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë përfshirjen e fondeve vendase dhe të huaja.

¹ Procesi i deinstitutionalizimit bazohet në VKM Nr. 706 dt.09.09.2020 "Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022" dhe Planine Veprimit për zbatimin e tij, si edhe në Urdhërin Nr. 548 dt.01.10.2020 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit Kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022". SOS Fshatrat e Fëmijëve . Tiranë është pjesë e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 ngritur pranë MSHMS.

NENI 3
Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila garanton të drejtat dhe liritë themelore të fëmijëve dhe mbështetet në legjislacionin në fuqi.

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi bazohet në dispozitat ligjore të parashkikuara si me poshtë:

Ligjin nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (te ndryshuar),
Ligjin nr.8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” të ndryshuar
Ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (të ndryshuar),
Ligjin nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”,
Ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
Ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve”;
Ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,
Ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”;

VKM nr. 658, datë 17.10.2005 për “Standardet e shërbimeve shoqërore”,
VKM nr.148, datë 13.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”
VKM nr.578 dt. 03.10.2018 “Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar/rezidencial, kriteret, procedurat për përfutimin e tyre në masën e shumës për shpenzime personale për përfutuesit e shërbimit të organizuar,
VKM nr.353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”.
VKM nr. 691, datë 29.7.2015, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, i ndryshuar “
VKM nr.465 dt.03.07.2019 “Per masat per mbrojtjen e femijeve nga aksesit ne permbajtje te paligjshme dhe/te demshme ne internet”;
VKM nr.659 dt.01.11.2021 “Per miratimin e Agjendes kombetare per te drejtat e femijeve 2021-2026”;
Udhëzimin e përbashkët nr. 651, datë 13.9.2019, “Për procedurat e raportimit, të rasteve të fëmijëve në nevojë, për mbrojtje;

NENI 4

Angazhimet e palëve

- 4.1 Organizata "SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri" merr përsipër të ofrojë **Shërbime të kujdesit shoqëror për grupet e marginalizuara** në Bashkinë e Shkodrës përmes larmishmërisë së ndërhyrjeve të specifikuara si: *"Shërbime komunitare"* të cilat specifikohen sipas kategorisë së përfituesve në:
- **Shërbime komunitare** për fuqizimin e individit/familjes sipas nevojave të identifikuara dhe referuara nga njësisia e vetëqeverisjes vendore në tre drejtime kryesore:
 - a) **Paketë shërbimesh direkte** (këshillim për punësimin, edukimin shëndetësor, arsimim, argëtim, mbështetje psiko-sociale dhe shëndetësore).
 - b) **Programet e Aftësisimit Prindëror** (Klasat e Prindërimit) për të mbështetur prindërit në zhvillimin e aftësive të tyre, për të ofruar mbrojtje, edukim dhe kujdes që fëmijët e tyre të rriten në një ambient familjar, social përkujdesës.
 - Zbatimin me fondet e veta të Projektit 'Adresimi i Nevojave sistematike- Mbështetje për reformat e mirëqënies së fëmijëve' me fokus në procesin e De-institucionalizimit në Bashkinë Shkodër duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit.
- 4.2 Të kontribuojë në vlerësimet për nevojat sociale të komuniteteve të qytetit të Shkodrës duke përfshirë në vlerësim ekspertë dhe duke lehtësuar procesin e vlerësimit nëpërmjet vrojtimeve, grupeve të fokusuara apo intervistave.
- 4.3 Të ndajë praktikën më të mirë dhe ekspertizën e saj në drejtim të krijimit të shërbimeve parandaluese apo reaguese të mbrojtjes së fëmijës me strukturën përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki.
- 4.4 Të zbatojë qasje që bazohen mbi të drejtat e fëmijës dhe mbi barazinë gjinore, si dhe të respektojnë standardet etike në proceset e planifikimit e zbatimit të programeve dhe projekteve të tyre.
- 4.5 Të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve e të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe profesionistëve në nivel vendor.
- 4.6 Të sigurojë dhe të ndajë me Bashkinë një kopje të raportit vjetor, përshkruar të zbatimit të projekteve dhe të dhënat e gjeneruara prej tij (hapat e ndërmarrë, kontributin, si edhe përfituesit e tyre që janë asistuar, shërbimet e ofruara, problematikat e hasura etj).

² individë e familje që kanë nevojë për kujdes shoqëror sipas perkufizimit të shtjelluar në Ligjin për shërbimet Shoqërore⁷ 121/2016.

- 4.7 Në drejtim të procesit të menaxhimit të rastit për fëmijën/individin/ familjen në nevojë do të zbatohet³ legjislacionin vendas. Hapat do të jenë:
- Të mbështesë dhe të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor duke referuar rastet në nevojë për shërbime të integruara pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe/ose Njesisë për të Drejtat e Fëmijëve (NJMF) në nivel të njësisë administrative /bashkie.
 - Të bashkëpunojë në menaxhimin e rastit të një fëmije/familje në nevojë me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe çdo strukturë tjetër sipas legjislacionit përkatës⁴ duke zbatuar detyrimet që rrjedhin si ofrues shërbimi në territorin e Bashkisë Shkodër.
 - Të marrë pjesë në veprimtarinë e grupeve teknike ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje/ familjeve në nevojë për vlerësimin dhe planifikimin e ndërhyrjeve.
 - Të mbështesin Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik/NJMF përmes ofrimit të shërbimeve për individët dhe familjet në përputhje me planin e kujdesit/Mbrojtjes të miratuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik /NJMF sipas legjislacionit.
 - Mbajtje e lidhjeve të rregullta me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik/NJMF lidhur me zbatimin e planit, dhe menaxhimin e çdo situatë problematike për t'ju përgjigjur nevojave të individëve (fëmijëve në nevojë për mbrojtje) dhe familjeve në nevojë.
 - Të dokumentojë dhe të ndajë informacione me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor/ Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik / Njësinë për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me mbështetjen e ofruar gjatë menaxhimit të rasteve çdo 2 muaj.
 - Të sigurojë mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit gjatë gjithë procesit të mbështetjes së rasteve të fëmijëve/familjeve në përputhje me ligjin në fuqi.

4.8 Në drejtim të procesit të de-institucionalizimit disa prej shtyllave kryesore të kësaj ndërhyrjeje do të jenë si më poshtë vijon:

A) Të zhvillojë modelin kombëtar të kujdesit për të rinjtë në një grup pune me aktorë publik dhe jopublik (përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Tiranë,

³ Ligji dhe VKM përkatëse të detajuara

⁴ VKM nr. 578 dt. 03.10.2018 "Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

Korçë, Vlorë, Shkodër, Shërbimi Social Shtetëror, Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, organizata partnere etj).

B) Të zhvillojë dhe hartojë një metodologji të llogaritjes së fondeve të financimit të shërbimit të familjes kujdestare duke përfshirë palët e interesit në mënyrë aktive në grupet e punës dhe dorëzimin e procedurës tek vendimarrësit në nivel qendror dhe lokal.

- a) Organizojë fushatën ndërgjegjësuese në Bashkinë Shkodër për të rritur vëmendjen e publikut në lidhje me nevojën për sistemin e familjeve kujdestare.
- b) Ofrojë rritje të njohurive për aktorë lokalë në Bashkinë Shkodër nëpërmjet trajnimeve/workshopeve tematike në lidhje me familjet kujdestare.
- c) Organizojë një vizitë studimore dy ditore për shkëmbimin e eksperiencave dhe marrjen e njohurive të reja të përfaqësuesve lokalë me fokus sistemin e familjeve kujdestare, ku të përfshihen përfaqësues të Bashkisë Shkodër.
- d) Hartojë dhe prezantojë një model për regjistrin e familjes kujdestare në Bashkinë Shkodër duke përfshirë në grupin e punës përfaqësues të ndryshëm të pushtetit lokal.
- e) Të identifikojë dhe mbështesë prindër/familje kandidate kujdestare për plotësimin e dokumentacionit të dosjes, vlerësimin psikologjik dhe trajnime të nevojshme.

C) Të zhvillojë metodologji që mbështesin profesionistët në punën me grupet e marxhinalizuara.

- a) Hartojë dhe prezantojë një dokument udhëzues për menaxhimin e rasteve dhe një sërë mjetesh pune të standartizuara për të mbështetur fëmijët dhe familjet në nevojë, të cilat nuk janë subjekt i VKM nr 578 për Menaxhimin e Rastit.
- b) Dizajnimin dhe kontekstualizimin e metodologjisë së dy programeve të prindërimit të bazuara në evidencë: (i) Programi i Fuqizimit të Familjes për grup moshën 6-11 vjeç, dhe (ii) Prindër të Fortë- Fëmijë të fortë.

D) Të ndërtojë kapacitetet e profesionistëve lokalë në punën me grupet e marxhinalizuara.

- a) Trajnimin e profesionistëve lokalë që punojnë direkt me fëmijën dhe familjen mbi metodat efektive dhe të qëndrueshme, në kuadrin e menaxhimit të rastit dhe procesit të re-integrimit të fëmijëve në familjen biologjike.
- b) Trajnimin e profesionistëve lokalë për njohuritë dhe metodat e nevojshme për të ofruar trajnime për aftësitë prindërore me dy modulet e prindërimit (i) Programi i Fuqizimit të Familjes për grup moshën 6-11 vjeç dhe (ii) Prindër të Fortë- Fëmijë të fortë.
- c) Trajnimin e profesionistëve lokalë me metodologjinë ndërkombëtare mbi metodat efektive të "largimit nga kujdesi".

F) Të ofrojë shërbime të drejtëpërdrejta për grupet e marxhinalizuara:

- a) Mbështetjen dhe fuqizimin e fëmijëve në nevojë të cilët janë në proces reintegrimi në familjet e origjinës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse me ekspertë sipas nevojave individuale të rastit dhe buxhetit në dispozicion.
 - b) Ofrojë trajnime për prindërit në nevojë me 2 programet e prindërimit me synim rritjen e aftësive prindërore.
- F) Të zhvillojë takime shkëmbyese çdo 3 muaj midis 2 palëve të përfshira në marrëveshje për të ndarë sfida dhe vështirësi gjatë procesit të implementimit të aktiviteteve dhe ofrimit të shërbimeve në Bashkinë Shkodër.
- G) Të sigurojë mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit gjatë gjithë procesit të mbështetjes së rasteve të fëmijëve/familjeve kujdestare.
- H) Të përgatisë planin vjetor të punës për secilin vit respektiv dhe ta ndajë atë me përfaqësues të Bashkisë Shkodër.

Bashkia merr përsipër:

- a) Të mbështesë dhe të marrë përsipër menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje/familjeve në nevojë të referuara nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, duke kryer identifikimin dhe vlerësimin e plotë të nevojave për shërbime.
- b) Të orientojë dhe të koordinojë nismat e ndërmarra nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri me iniciativa të tjera, në kuadër të zbatimit të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët ose të programeve të tjera.
- c) Të koordinojë dhe harmonizojë përpjekjet institucionale mes saj dhe SOS Fshatrave të Fëmijëve Shqipëri në veprimtaritë dhe shërbimet e munguara ose që nuk plotësohen nga institucionet shtetërore.
- d) Të mbështesë, kur është e mundur, financimin e shërbimeve e të nismave të organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në mbështetje të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi.
- e) Të mbështesë organizatën SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nëpërmjet orientimit të donatorëve vendës e ndërkombëtarë, për zbatimin në nivel vendor të objektivave të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët apo për plotësimin e shërbimeve, të programeve ose nevojave të tjera në përgjithësi, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor.
- f) Të vendosë në dispozicion sipas nevojave ambjente të përshtatshme.
- g) Shkodër, si kontribut nga ana e saj për implementimin e projekteve dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në shërbim të grupeve të marginalizuara, në rrjetin e Qendrave Komunitare "Për Familjen".

- h) Të lehtësojë procesin e koordinimit ndërmjet SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri me institucionet shtetërore në nivel qendror e vendor, për realizimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, me fokus të veçantë fëmijët dhe grupet vulnerabel.
- i) Të marrë pjesë aktive në organizimin dhe implementimin e fushatës ndërgjegjësuere në Bashkinë Shkodër për të rritur vëmendjen e opinionit publik në lidhje me nevojën për sistemin e familjeve kujdestare.
- j) Të marrë pjesë me përfaqësuesit e saj në mënyrë aktive në grupet e punës që do të ngrihen për hartimin e koncepteve, metodologjive, udhëzimeve etj si më sipër përmendur.
- k) Të integrojë regjistrin e familjeve kujdestare si pjesë e sistemeve elektronike të shërbimeve sociale.
- l) Të kontribuojë në ngritjen e familjeve kujdestare nëpërmjet koordinimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me stafin e projektit të DE-Institucionalizimit.
- m) Të përzgjedhë dhe mundësojë pjesëmarrjen e profesionistëve lokalë në trajnimet e planifikuara në kuadër të këtij projektit në përputhje me tematikat përkatëse dhe fushën e shërbimeve që ata mbulojnë.
- n) Të sigurojë që punonjësit e trajnuar dhe certifikuar të ofrojnë në vijim trajnimet respektive me prindër dhe fëmijë në qendrat komunitare dhe strukturat lokale sipas fushës në të cilën janë trajnuar.
- o) Të nxisë dhe të krijojë mundësi efektive të bashkëpunimit, duke përfshirë ato për pjesëmarrjen e fëmijëve.
- p) Të ndajë informacione dhe të dhëna që disponojnë mbi situatën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës.
- q) Të zbatojë si programe për fuqizimin e kapaciteteve prindërore në rrjetin e Qendrave Komunitare "Për Familjen" dy modulet e Prindërimit (i) Programi i Fuqizimit të Familjes (SFP 6-11 vjeç) dhe (ii) Prindër të Fortë - Fëmijë të Fortë.

NENI 5

Personat e Kontaktit

- a. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:
 - Për Bashkinë:

 - Imelda Kraja, Drejtor, Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

- Për organizatën:

- b. Këta persona do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me marrëveshjen e palëve.
- c. Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

NENI 6

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë 2 vjeçare.

NENI 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit, me bisedime ndërmjet tyre, në të kundërt palët kanë të drejtën t'i adresohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

NENI 8

Dispozita të fundit

- a. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj marrëveshje.
- b. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve, për të qenë partnere në zbatimin e projektit në ljalë, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive të projektit në interes të mirëqënies së fëmijëve në gjendje të vështirë dhe familjarëve të tyre.
- c. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
- d. Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, janë anekset bashkëgjitur saj.

- e. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në katër kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

PËR
BASHKINË SHKODËR
KRYETAR
Z. Bardh Spahia



PËR
SOS FSHATRA TË FËMIJËVE
DREJTOR KOMBËTAR
Zj. Adela Maçi

